

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41. /2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga SMURFIT KAPA GRUP PLC, me seli në Biç Hill, Klonskig, Dublin 4, Irlandë, përmes avokates Andrea Lazarevska, nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 15.01.2024, mori këtë

### **AKTVENDIM**

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin kompania holding e sapokrijuar në Irlandë (që do të riemërtohet Smurfit VestRok plc, me zyrë të regjistruar në Biç Hill, Klonskig, Dublin 4, Irlandë) e cila është një Ndërmarrje filial e SMURFIT KAPA GRUP PLC, me zyrë të regjistruar në Biç Hill, Klonskig, Dublin 4, Irlandë do të blejë të gjithë kapitalin aksionar të lëshuar të SMURFIT KAPA GRUP PLC dhe të gjithë kapitalin aksionar të lëshuar të VestRok Kompani, me adresë në 1000 Abernati Roud , NE Atlanta , GA 30328, SHBA, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

### **Arsyetim**

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 21.11.2023, ndërsa e plotësuar më 06.12.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim i përqendrimit nga SMURFIT KAPA GRUP PLC, me seli në Biç Hill, Klonskig, Dublin 4, Irlandë, ku kompania holding e sapokrijuar në Irlandë e cila aktualisht është një ndërmarrje filial e SMURFIT KAPA GRUP plc, me seli në Biç Hill, Klonskig,, Dublin 4, Irlandë (që do të riemërtohet Smurfit VestRok plc me zyrë të regjistruar në Biç Hill, Klonskig 4, Dublin Irlandë) do të blejë të gjithë kapitalin aksionar të emetuar të SMURFIT KAPA GRUP plc dhe gjithashtu VestRok Kompani, me një adresë 1000 Abernati Roud, NE Atlanta, GA 30328, SHBA do të jetë ndërmarrje filial në pronësi të plotë të Smurfit VestRok plc.

Transaksioni i propozuar do të zbatohet përmes disa hapave:

- Kompania holding e sapokrijuar në Irlandë e cila aktualisht është ndërmarrje filial e SMURFIT KAPA GROUP plc (që do të riemërtohet Smurfit WestRock plc)<sup>1</sup> do të blejë të gjithë kapitalin aksionar të emetuar të SMURFIT KAPA GRUP plc nëpërmjet një skeme marrëveshjeje sipas nenit 450 të Ligjit për Shoqëri Tregtare të vitit 2014 në Irlandë, me të cilën SMURFIT KAPA GRUP PLC bëhet një ndërmarrje filial në pronësi të plotë të Smurfit VestRok plc, dhe
- Kompania e re degë amerikane e Smurfit VestRok Plc ("**Merxher Sab**")<sup>2</sup> do të bashkohet me dhe në VestRok Kompani, pas së cilës ekzistenca e veçantë e korporatës e Merxher Sab do të pushojë ndërsa VestRok Kompani do të vazhdojë si një korporatë që vazhdon të ekzistojë ("Korporata që vazhdon të ekzistojë"), kështu që pas këtij bashkimi, Korporata që vazhdon të ekzistojë do të jetë një ndërmarrje filial në pronësi të plotë të Smurfit VestRok Plc.

Si rezultat i bashkimit të Merxher Sab dhe VestRok Kompani, Smurfit VestRok Plc (që në atë kohë do të zotëronte tashmë të gjitha aksionet e SMURFIT KAPA GRUP PLC) gjithashtu do të fitonte kontrollin e vetëm mbi VestRok Kompani (sepse VestRok Kompani do të vazhdojë si korporata që vazhdon të ekzistojë pas bashkimit të Merxher Sab dhe VestRok Kompani, në pronësi të plotë të Smurfit VestRok Plc), ndërsa aksionaret e SMURFIT KAPA GRUP PLC dhe VestRok Kompani do të bëhen aksionarë të Smurfit VestRok plc.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim, shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

#### **Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

**SMURFIT KAPA GROUP PLC**, shoqëria FTSE 100 dhe shoqëria mëmë e Smurfit Kapa Grup (*Smurfit Kappa Group*) është një nga ofruesit kryesorë të zgjidhjeve të paketimit me bazë letre në botë, me më shumë se 47,000 punonjës në mbi 350 vende prodhimi në 36 vende dhe me të ardhura prej 12.8 miliardë euro në 2022. SMURFIT KAPA GRUP PLC gjendet në 22 vende të Evropës, 13 në Amerikë dhe një në Afrikë. SMURFIT KAPA GRUP PLC është i vetmi lojtar pan-rajonal në shkallë të gjerë në Amerikën Latine. Produktet e saj, të cilat janë 100% të rinovueshme dhe të prodhuara në mënyrë të qëndrueshme, përmirësojnë ndikimin mjedisor të klientëve të saj.

SMURFIT KAPA GRUP PLC nuk ka ndërmarrje ndihmëse, degë apo zyra përfaqësuese të vendosura në Maqedoninë e Veriut, por ka pasur shitje në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

---

<sup>1</sup> Sifajdvej Limited (Cepheidway Limited) (e cila do të riemërohet dhe reregjistrohet si Smurfit VestRok Plc), një shoqëri private e kufizuar e themeluar në Irlandë me numër regjistrimi 607515 me seli të regjistruar në Biç Hill, Klonskig, Dublin 4, Irlandë (Beech Hill, Clonskeagh, Dublin 4, Ireland).

<sup>2</sup> San Merxher Sab LLC (Sun Merger Sub, LLC), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e organizuar në shtetin e Delaver, SHBA.

**VestRok Kompani**, një shoqëri publike me seli në SHBA, është një ofrues shumëkombësh i zgjidhjeve inovative, të qëndrueshme të letrës dhe paketimit, kryesisht aktive në Shtetet e Bashkuara, por që operon gjithashtu në Evropë, Amerikën e Veriut, Amerikën e Jugut, Azi dhe Australi.

VestRok Kompani është aktive në prodhimin dhe furnizimin e ambalazheve prej kartoni, kartonave të palosshme, kontejnerëve të kartonit dhe produkteve të ambalazhimit të valëzuar, midis produkteve dhe shërbimeve të tjera. Në BE, WestRock Company është e fokusuar në shitjen e kartonave të palosshme, etiketave, fletëpalosjeve, kartonit, kanaçeve të përbëra dhe makinerive të paketimit.

VestRok Kompani nuk është aktive në Maqedoninë e Veriut, as nuk ka ndërmarrje ndihmëse, degë apo zyra përfaqësuese në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

### **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**

**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**

**Prof. Dr. Владимир Наумовски**

